

**RAMI MEMUSHAJ****VEÇORI SINTAKSORE TË TË FOLMEVE TË LABËRISHTES**

I. Labërishtja, si një nga dy nënndarjet e toskërishtes jugore, flitet në trevat që ndodhen në jugperëndim të toskërishtes veriore a të mirëfilltë, me kufi ndarës lumin e Vjosës, deri në lumin e Shalësit në jug, ku fillojnë trevat e çamërishtes, nënndarjes tjetër të toskërishtes jugore<sup>1</sup>.



Trevat e labërishtes shtrihen në arealin që në veri përfshin qytetin e Vlorës dhe të Selenicës; në lindje qytetin e Tepelenës dhe krahinën e Zagorisë; ndërsa në jug Dropullin, Muzinën, Delvinën dhe Sarandën. Pra, jo vetëm në

---

<sup>1</sup> J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1988, f. 108.

treven e Labërisë etnografiko-gjeografike, po edhe në ato që prof. E. Çabej i quan treva “labëronjëse”, si Topalltia e Vlorës, Lunxhëria e Zagoria, d.m.th. zona midis Drinos dhe Vjosës. Ky nëndialekt përfshin një numër jo të vogël të folmesh krahinore, ndarja e të cilave, sikundër ka vënë në dukje qysh 50 vjet më parë studiuesi i tyre M. Totoni, «ka më tepër bazë etnografike»<sup>2</sup>. Kështu, në përputhje me nënnjësitë etnografike të Labërisë, duke zbritur nga veriu drejt jugut dallohen këto ligjërime krahinore: e folmja e Topalltisë, e folmja e Kudhës-Grehotit, e folmja e Lopësit dhe e Rrëzës së Tepelenës, e folmja e Zagorisë; më në brendësi, gjithnjë nga veriu në jug, e folmja e Mesaplikut, e folmja e Kurveleshit, e folmja e Kardhiqit, e folmja e Gjirokastrës, e folmja e Lunxhërisë, e folmja e Dropullit dhe e folmja e Muzinës; dhe në perëndim e folmja e Dukatit, e folmja e Bregut të Sipërm, e folmja e Bregut të Poshtëm, e folmja e Rrëzomës dhe e folmja e Delvinës.

Megjithatë, duhet pranuar se ky numër të folmesh nuk është i përcaktuar saktësisht dhe duhet marrë si i përafërt. Shkaku është se në qendrat e banuara të krahut të djathtë të luginës së Vjosës, nga Selenica në Tepelenë, dhe në ato të të dy krahëve luginës së Drinos nuk janë bërë ekspedita gjuhësore. Kështu, në “Dialektologjia shqiptare”, përmenden të folmet e Libohovës dhe të Nepravishtës<sup>3</sup>, por jo e folmja e Lunxhërisë, ndërkohë që Lunxhëria njihet si një njësi etnografike.

Deri më sot, nga këto ligjërime krahinore janë studiuar e folmja e Zagorisë, e folmja e qytetit të Gjirokastrës, e folmja e Muzinës, e folmja e Bregdetit të Poshtëm dhe të folmet e Kurveleshit nga M. Totoni që në vitet ‘60, si dhe e folmja e Bregut të Sipërm (e Himarës) nga N. Sotiri (E folmja e Qeparoit, 2004) dhe Memushaj-Grillo (2009).

Edhe për fjalorin dialektologjik janë mbledhur të dhëna vetëm në 11 pika, të cilat mbulojnë këto të folme: pikat 116 (Vlorë) dhe 117 (Matogjin) për të folmen e Mesaplikut (për të folmen e Mesaplikut disa tekste janë mbledhur nga autori në fillim të viteve ‘70); pika 118 (Dukat) për të folmen e Dukatit; pika 119 (Progonat) për të folmen e Kurveleshit të Sipërm dhe 121 (Fterrë) për të folmen e Kurveleshit të Poshtëm; pika 120 (Vuno) për të folmen e Bregut të Sipërm; pika 122 (Lukovë) për të folmen e Bregut të Poshtëm; Pika 139 (Sheper) për të folmen e Zagorisë; pikat 141 e 142 (Gjirokastrë) për të folmen e Gjirokastrës; dhe pika 144 (Delvinë) për të folmen e Delvinës.

<sup>2</sup> M. Totoni, *Vëzhgime rreth së folmes së Gjirokastrës*, SF, 1966, 1, f. 111.

<sup>3</sup> J. Gjinari, *Dialektologjia shqiptare*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 1988, f. 44.



Siç shihet, një pjesë e konsiderueshme e të folmeve të labërishtes nuk janë studiuar dhe, rrjedhimisht, për to nuk kemi mundur të sigurojmë të dhëna. Po edhe për të folmet që janë studiuar, të dhënat sintaksore nuk janë të mjaftueshme, pasi, siç është vënë në dukje në “Parathënien” e “Atlasit dialektologjik”, «gjurmimi dhe regjistrimi i fakteve dhe i dukurive sintaksore kërkojnë më shumë kohë se hulumtimi i veçorive fonetike, morfologjike e leksikore»<sup>4</sup>. Si rrjedhim, çfarë do të paraqitim në këtë kumtesë mund të shihet vetëm si një sprovë për të paraqitur tiparet sintaksore të të folmeve të labërishtes së një gjysmë shekulli më parë.

Një problem tjetër që na ka dalë është se, me përjashtim të folmes së Himarës, të dhënat janë të vjetra, të vjela më shumë se gjysmë shekulli më parë. Shtresimi i ndryshëm kohor na ka penguar edhe të nxjerrim material nga përmbledhjet e folklorit të shek. XIX. Nëse për gjuhën e shkruar një periudhë e tillë kohore nuk është e rëndësishme, për gjuhën e folur është ndryshe, pasi janë ndërruar dy breza folësish dhe gjatë kësaj kohe shkollimi ka bërë punën e vet, duke rrafshuar, sidomos nën ndikimin e gjuhës standarde, disa tipare arkaike të ligjërit të brezit të vjetër. Ndërmartja e një projekti për studimin e

<sup>4</sup> M. Domi, *Parathënie*, “Atlasi dialektologjik i Shqipërisë”, vëll. I, Napoli, 2007, f. 10.

veçorive sintaksore të dialekteve të shqipes mendojmë se si hap të parë ka këtë konferencë<sup>5</sup>, që shërben më shumë për të thyer paragjykimin se në sintaksë nuk ka dallime dialektore; si hap i dytë do të ishte përpilimi, në bashkëpunim me dialektologët, që janë edhe autorë të atlasit dialektor, i një pyetësori më të plotë tiparesh sintaksore; si hap të tretë identifikimin e të folmeve që do të shërbejnë edhe si pika anketimi; si hap të katërt përgatitjen në një seminar të pedagogëve dhe të mësuesve të gjuhës shqipe që do të punojnë në terren për mbledhjen e të dhënave; si hap të pestë ekspeditat në terren për mbledhjen e materialit; dhe si hap të fundit përpunimin e të dhënave të mbledhura dhe hartimin e atlasit të veçorive sintaksore.

Si të folme të shqipes, ligjërimet krahinore dëshmojnë disa tipare të përbashkëta të sintaksës së gjuhës së folur, ndër të cilat po përmendim mbizotërimin e lidhjes së fjalive me anë të intonacionit; përdorimi më i rrallë të lidhëzave, sidomos në periudhat me fjali të bashkërenditura; përdorimi i lidhëzave shtuese *dhe*, *edhe* në fillim të fjalive; luhatjet në përdorimin e nyjave të përparme etj. Po kur i vihesh krahasimit të të folmeve të një nëndialekti, ajo që të bie në sy menjëherë është se edhe në fushën e sintaksës midis tyre ka dallime, sado të pakta qofshin ato. Kështu që pohimi se në sintaksë dallimet dialektore janë shumë të pakta provohet se nuk është i vërtetë. Kjo na ka rezultuar edhe në gjatë analizës së të dhënave për të folmen e Mesaplikut, të Bregut të Sipërm (Himarës), Bregut të Poshtëm, Kurveleshit, Gjirokastrës, Muzinës dhe të Zagorisë.

Një gjë tjetër që të bie në sy kur i vihesh gjurmimit të veçorive sintaksore, është se në mjaft raste të folme kufitare nuk ndajnë të njëjtin tipar sintaksor, ndërkohë që të folme jokufitare kanë tipare të njëjta. Kjo na shtyn të pranojmë pohimin e F. de Sossyrit se «ka vetëm veçori dialektore të natyrshme, nuk ka dialekte të natyrshme»<sup>6</sup>. Prandaj metoda që kemi ndjekur është ajo e gjurmimit të tipareve sintaksore, të cilat në fund do të përpiqemi t'i paraqitim në një pasqyrë me anë të pluseve.

## II. Tipare të veçanta të të folmeve labe

**1. Ambigjenia: MUZINË** – *vende të bukura, këto plane*; por *male të lartë, këta djepe, me tre pate*; **GJIROKASTËR** – *na këto pesë napolona, nam dhe pesë napolona tjera, kuelt e hamëshuara doni apo thikët e pikëtë?*, mishra të pjekura; **ZAGORI** – *këto marifete, e plot zanate të tjera, ilaçe të mira*; por *gruzhde të vogjij, barqe të mëdhenj, sherqet e bardhë*; **KURVELESH** – *ilaçet*

<sup>5</sup> Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Variacioni sintaksor në dialektet dhe të folmet e shqipes”, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Tiranë, 15 dhjetor 2016.

<sup>6</sup> F. De Saussure, *Cours de linguistique générale*, Editions Payot & Rivages, Paris, 1997, f. 276.

e *mira*, *këto* zakone, *dëme* të *mëdha*, *malet* e *larta*, *vreshta* të *mira*; *këto* fshatrat *këtej*; por djepe të *mëdhenj*, shërqet i vishn të *bardh*; **MESAPLIK** – *ato* ugaret, *ca halle* të *vogla*.

**2. Mungesa e nyjës: GJIROKASTËR** – *çarçafi jastëkut*, *zogu natës*, *Bregu Madh*, *i thuaj nënës djalit*, *pas gjishes tire*; **BREGDETI I POSHTËM** – nuk përdoret *nyja* e përparme pas emrash mashkullorë në gjinore (të babit Hakes), para mbiemrash e përemrash të nyjshëm (vëllait vogël, nga të shokëve tu; **HIMARA** – *valëvet detit*, *malevet larta*, *fushavet gjëra*, *kullotavet mira*, *ujëravet lumit*, *brinjëvet malit*; **KURVELESH** – *Lugu Gjoke*, *greku par*, *djali kushëriut par*, *i thotë ati birit mretit*, *këtire gurëve vegjël*, *djali vajzës madhe*, *vajzës kunatit*; por me nyjë: *Bregu i Guvës*, *tharku i keçere*.

### 3. Nyja së në vend të të

**Nyja së në vend të të: MUZINË** – *planit së Muzinës*, *gruan e kushëriut së parë*, *u thua së tërëve*, *atit së vogëlit*; **GJIROKASTËR** – është përgjithësuar *nyja së* edhe për emrat mashkullorë: *i thotë së gjadhit*, *robat e atija së vdekurit*. Në **KURVELESHIN E POSHTËM** dhe **BREGDETIMIN E POSHTËM**: *anës e detit (së detit)*, *e pajës e nuses*, *pran shtëpisë e mbretit*.

**4. E ardhmja arkaike: HIMARË** – *kam t'i thom di fjalë* (do t'i them); **KURVELESH (Çorraj)** – *ka të thotë* (do të thotë), *kan të thon* (duan të thonë)

**5. Parafjala më në vend të në, me, nga: ZAGORI** – kohë: *vate ai i madhi te gruaja më darkë*, *rri më darkë në shtëpi*; **KURVELESH** – për të treguar kohë: *që m saba*; vend: *është më vëne të mëshehura*, *e heth më trast*; mjet: *luan më to*, *shkop që ecij më të*; marrëdhënie të ndërsjella: *jam frir më njërin*, *kam një inat më tia*; raporte të tjera: *do haji më ato kumulla*, *nuk kemi m ato na* (nga ato); *do di vashast e tua nuse më ne*; **HIMARË** – vend: *më fshat*, *më kalë*, *më pemë*.

**6. Mungesa e parafjalës përpara emrave të vendeve: HIMARË** – *Vate Vlorë*. *Makina mbeti Dukat* (po jo tek emrat e përgjithshëm: *vate në shtëpi*); **MESAPLIK** – *na vete kurbet* (=në kurbet) ai... *mbeti kurbet* (=në kurbet)

**7. Mungesa e trajtës së shkurtër: KURVELESH** – *të bie tia lira* (të të bie), *çtë dëftoj ti a i vrar* (ç'të të dëftoj), *kan lën mua plakun* (më kanë lënë), *çokush kërkon mua* (më kërkon); **ZAGORI** – *atere të marrç mua* (të më marrësh), *unë s'ruaj ty* (s të ruaj), *po ja, ka ju* (u ka ju), *dal pa të shoq ç kam për të bërë* (për të të bërë) *unë ty*.

### 8. Përshtatja e kryefjalës së shprehur me emër kolektiv me kallëzuesin

**GJIROKASTËR** – ...i dhim faqia që *ipin* mileti që *hajnë* mane, gjithë bota të *hanë*; **KURVELESH** – mo më *han* kafshëria, e *rrethosën* koshadhja, na u *vran* ushtëria, do *ven* në dasm bota, e *marrën* qeveria; e *vrisn* fshati;

**9. Lidhëza posa (që) në fjali kushtore: MUZINË** – *posa* ke mëmën ç e do babanë, s ri dot me shoqera *posa* që të jetë pisë/ vete dhe u se *posa* të mos vete isha nga pesë napolona; **BREGDETI I POSHTËM** – *posa* s'je bër ti mënjemath/ mua më plaçin këta (Në **qoftë** se nuk je bërë ti mendjemadh, mua...), **KURVELESH (Çorraj)** – se *posa* të mos vijn i vrit (se, **po** të mos vinin, i vriste)

	Ambigjenia	Mungesa e nyjës	Nyja së për...	i Futuri vjetër	Parafjala më	Mungesa e parafjalës	Mungesa e tr. së shk.	Përshtatja e S me P	Lidh. kusht. <i>posa</i>
	1	2	3	4	5	6	7	8	9
Muzina	±	-	+	-	?	-	+	?	+
Gjirok.	+	+	+	-	-	?	-	+	-
Zagoria	±	+	?	-	+	-	+	?	?
Kurvel.	±	+	-	± (+Ç)	+	?	+	+	± (+Ç)
Bregu i Poshtëm	?	+	-	± (+P,N,B)	?	-	-	?	± (+B)
Himara	?	+	?	+	+	+	-	?	-
Mesapl.	+	+	?	-	+	+	-	?	-

(Prani e tiparit (+), Mungesë e tiparit (-), Mungesë dhe prani e tiparit (±), Mungesë të dhënash (?))

### III. Tipare të përbashkëta

Në të gjitha të folmet e bëra objekt në këtë shkrim hasen këto tipare të përbashkëta:

#### 1. Parapëlqimi i lidhjes me bashkërenditje në vend të nënrenditjes:

*Ish një njerë // kish gjetur dy vajza (=që kish...).* *Ish një baba // kish nëndë vajza (=që kish...).* *Qe një plak // i vdiq gruaja (=që i vdiq...)*...

**2. Bashkërenditja pa lidhëza**, me intonacion numërimi:

*Hodhi i madhi një moll/ mori një grua (dhe mori...).* *Dhe ata ashtu bë::n// van më der/ trokëll më der (dhe trokitën)*

*...plaku mbajti shtëpi::n dhe maçin/ plaka mori dhi::t/ mori dhe kokoshin (kurse plaka...)*

**3. Fjali të varura pa lidhëza:**

*Qe një aga/ kish një çoban// s ja kullot mir bagëti:n* (Qe një aga **që** kish një çoban...).

*tin ec, un s los dot nga vendi (se un...); Ish një njerë/ kish gjetur dy vajza (që kish gjetur); e nxirje qënë në vështë/ nuk hin kollaj tjetri (po ta nxirje...);*

**4. Lidhëzat dhe, edhe në fillim të fjalisë:**

*edhe* ngarkojn një gomar me eshk/ *dhe* e kapçojti ai/ *dhe* ju dhes eshka në bark;

*dhe* ai u menua/ “për se doji/ u tha atire t ëmtave/ për bisht të hatllarëve/ apo maj haxharëve?”// *dhe* ato ju përgjejn: “për bisht të hatllarëve”//

**5. Sandhia sintaksore**

Mjaft e përhapur është edhe dukuria e sandhisë sintaksore, po me shtrirje jo të njëjtë të njësive të përfuara nga përngjitja e fjalëve të sintagmave gjegjëse. Kështu, në të folmet e bregdetit përdoren rëndom formulat e betimit *shadjalënë* (qafsha djalënë), *shavëllanë* (qafsha vëllanë), *shatí* (qafsha ty), *shajú* (qafsha ju) (Mbamëni shoqe, *shaju*, të vajtoj dhe u me ju); në të folmen e Kurveleshit *ashtupóti* (ashtu, po ti?), *héuk* (haje ujk), *kojdíu* (ku e di unë), *modrúa* (mos u druaj), *nukegjérp* (nduk e gjerb) (të mos e bësh bukën përshesh në një lëng); në të folmen e Mesaplikut *quatí* (që thua ti) (Ali Asllani) etj.

\* \*

\*

Sikundër shtrihet edhe nga ky parashtrim joshterues, përveç tipareve të përbashkëta, të folmeve të folmet e labërishtes kanë një numër jo të vogël dallimesh sintaksore, të cilat duhen hetuar më hollësisht në trevat që mbulojnë këto të folme. Po që vjelja e veçorive sintaksore të jetë shteruese, nevojitet një pyetësor sa më i detajuar, në të cilin do të mbështeteshin ata që do të punojnë në terren me informatorët, të zgjedhur edhe këta sipas kriteresh të njëjta.

## SUMMARY

### SYNTACTIC FEATURES OF LABËRIA VARIANT

The Lab subdialect, or Labërishte, as one of three subdialects of Tosk, is spoken in the Southwestern Albania, in the territory between the Jonian sea and the Vjosa river, excluding the territory on the west of lower flow of the Shushica river, extending toward the south to Sarandë–Delvinë–Gjirokastër road, including Lunxhëria and Zagoria regions. This subdialect has about 14 local dialects, namely those of Topallti, Kudhës-Grehot, Lopësi, Rëza e Tepelenës and of Zagoria; of Mesapliku, Kurveleshi, Kardhiqi, Gjirokastra and its outskirts, Lunxhëri, Dropulli (?) and of Muzina; of Dukati, Upper Himara, Lower Himara, Rrëzoma and that of Delvina, although this number is not verified *in loco*. The number of local dialects of Labërishte may be greater, but the lack of dialectological studies for the territories of Rrëza e Tepelenës, and those of the Drino valley makes it difficult to do subtle divisions.

By our dialectologists only six of these dialects are being studied, which in the “Dialectological Atlas” of Albanian are represented by 11 points where dialectal materials are collected, exactly point 116 (Vlorë), and 117 (Matogjin) for the Mesapliku dialect; point 118 (Dukat) for the Dukati dialect; point 119 (Progonat) for the Upper Kurvelesh dialect, and 121 (Fterrë) for the Lower Kurvelesh dialect; point 120 (Vuno) for the Upper Himara dialect, and point 122 (Lukovë) for the Lower Himara dialect; point 139 (Sheper) for the Zagoria dialect; point 141, and 142 for the Gjirokastër dialect; and point 144 (Delvinë) for the Delvina dialect.

These local dialects have in common a number of features such as the presence of long vowels, of a more retracted [ë] vowel, the assimilation in some of them of *mb*, *nd*, *ng*, *ngj* clusters, and the infinitive in *-ur*. More common features have these dialects in the field of morphology and syntax. In this last field it deserves to be mentioned the predominant use of coordination, of asyndetic clauses, of coordinative conjunctions at the beginning of sentences, and syntactic sandhi of some very old syntagma, especially in Kurvelesh and Himara.

Even from this list of common features it comes clear that this subdialect is not so compact. The reasons for such a great number of local dialects in a relatively small area are the mountainous nature of the region, the rivers that divide its parts, and the isolation of this small ethnographic units because of the absence in the past of roads. From dialectal descriptions and materials collected in the territories of the studied varieties it comes out that, beside phonetic,

morphological, and lexical differences, these speeches differ also in their syntax. Studying dialectal texts from these local varieties, we have discerned the following syntactic features:

1. **Presence of ambigeny vs. its absence** – according to collected materials, ambigeny is present in the Gjirokastër and Mesaplik dialect, while fluctuations are observed in Muzinë, Zagori and Kurvelesh dialects.

2. **Absence of the preposed article vs. its presence** – generally the preposed article is not used in labërishte, although it remains to be further investigated, because of the paucity of evidence. Only in the Upper Himara dialect this article is found, but with certain restrictions.

3. The article *së* instead of *të* – the *së* before masculine nouns is used only in the local dialects of Muzinë and Gjirokastër; in other dialects it is not found before masculine nouns.

4. The archaic future *kam+conjunctive* is registered only in the dialect of Upper Himara and in the Çorraj village of Kurvelesh.

5. The preposition *më* in place of *në, me, nga* – these prepositions are found in the local dialects of Zagori, Kurvelesh and Himarë.

6. The absence of preposition *në* before place names – this phenomenon is met only Himarë and Mesaplik.

